

Konventë lidhur me Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore

Data e hyrjes në fuqi të konventës: 17.12.1975

Data e ratifikimit: 10.07.1989

Data e hyrjes në fuqi për Shqipërinë: 10.10.1989

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO) e mbledhur në Paris nga 17 tetori deri në 21 nëntor 1972, në sesionin e saj të shtatëmbëdhjetë,

Duke vënë re që trashëgimia kulturore dhe trashëgimia natyrore janë gjithnjë e më shumë të kërcënuara nga shkatërrimi jo vetëm prej shkaqeve tradicionale të degradimit, por gjithashtu edhe prej kushteve shoqërore dhe ekonomike në ndryshim të cilat e përqesojnë situatën me më shumë fenomene të tmerrshme dëmtimi ose shkatërrimi,

Duke konsideruar se zvetërimi ose zhdukja e ndonjë objekti të trashëgimisë kulturore dhe natyrore përbën një varfërim të dëmshëm ndaj trashëgimisë të të gjitha kombeve të botës,

Duke konsideruar se mbrojtja e kësaj trashëgimie në nivel kombëtar shpesh mbetet e paplotë për shkak të shkallës së burimeve të cilat kërkohen dhe burimeve të pamjaftueshme ekonomike, shkencore dhe teknologjike të shtetit ku ndodhet pasuria që duhet mbrojtur,

Duke kujtuar se Kushtetuta e Organizatës garanton që do të ruajë, rrisë dhe shpërndajë dije, duke siguruar konservimin dhe mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore dhe rekomandimin e konventave të nevojshme ndërkombëtare ndaj shteteve të interesuara;

Duke konsideruar se konventat ekzistuese ndërkombëtare, rekomandimet dhe rezolutat lidhur me pasurinë kulturore dhe natyrore demonstrojnë rëndësinë, për të gjithë njerëzit e botës, e mbrojtjes të kësaj pasurie unike e të pazëvendësueshme, pavarësisht se kujt populli i përket,

Duke konsideruar se pjesë të trashëgimisë kulturore dhe natyrore janë të një interesi të jashtëzakonshëm dhe prandaj është e nevojshme të ruhen si pjesë e trashëgimisë botërore e njerëzimit dhe si një e tërë,

Duke konsideruar se, duke parë madhësinë dhe rrezikshmërinë e rreziqeve të reja që i kërcënon ato, është detyrë e komunitetit ndërkombëtar si i tërë që të marrë pjesë në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore me vlerë të jashtëzakonshme universale, duke dhënë një ndihmë kolektive e cila megjithëse nuk zë vendin e veprimit të shtetit të interesuar do të shërbejë si një plotësues efikas për të,

Duke konsideruar se është thelbësore që për këtë qëllim të miratojë dispozita të reja në formën e konventës duke themeluar një sistem efikas të mbrojtjes kolektive të trashëgimisë kulturore dhe natyrore me vlerë të jashtëzakonshme universale, e organizuar mbi baza të përhershme dhe në përputhje me metoda moderne shkencore,

Duke vendosur, në sesionin e saj të gjashtëmbëdhjetë se kjo çështje duhet bërë temë e një konvente ndërkombëtare,

Miraton në këtë ditë të 16-të nëntori këtë Konventë.

I. PËRKUFIZIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE DHE NATYRORE

Neni 1.

Për qëllimin e kësaj Konvente, këto më poshtë do të konsiderohen si “trashëgimi kulturore”

monumente: vepra arkitekturore, vepra të pikturës dhe skulpturës monumentale, elemente ose struktura të një natyre arkeologjike, mbishkrime, vendbanime në shpella dhe kombinime tiparesh, të cilat janë me një vlerë të jashtëzakonshme universale nga pikëpamja historike, e artit dhe shkencës;

grupe ndërtesash: grupe ndërtesash të ndara ose të lidhura, të cilat për shkak të arkitekturës së tyre, homogjenitetit të tyre, ose vendit të tyre në peizazh, janë me vlerë të jashtëzakonshme universale nga pikëpamja historike, e artit dhe shkencës;

site: veprat e njeriut ose veprat e gërshetuara të natyrës dhe njeriut, zonat që përfshijnë site arkeologjike të cilat janë me vlerë të jashtëzakonshme universale nga pikëpamja historike, estetike, etnologjike ose antropologjike;

Neni 2

Për qëllimet e kësaj konvente këto më poshtë do të konsiderohen si “trashëgimi natyrore”

tipare natyrore që përbëhen nga formacione fizike dhe biologjike ose grupe të këtyre formacioneve, të cilat janë me vlerë të jashtëzakonshme universale nga pikëpamja estetike ose shkencore;

formacione gjeologjike dhe fiziko-grafike dhe zona të përcaktuara saktë të cilat përbëjnë vendbanimet e specieve të kërcënuara kafshësh dhe bimësh me vlerë të jashtëzakonshme universale nga pikëpamja e shkencës ose konservimit;

site natyrore ose zona natyrore të përcaktuara saktë me vlerë të jashtëzakonshme universale nga pikëpamja e shkencës, konservimit ose bukurisë natyrore.

Neni 3

Duhet që çdo shtet palë në Konventë të identifikojë dhe përcaktojë pasuritë e ndryshme që ndodhen në territorin e tij të përmendura më sipër në Nenin 1 dhe Nenin 2.

II. MBROJTJA KOMBËTARE DHE MBROJTJA NDËRKOMBËTARE E TRASHËGIMISË KULTURORE

Neni 4

Cilido Shtet Palë në këtë Konventë pranon se detyra e identifikimit, mbrojtjes, konservimit, prezantimit dhe transmetimit tek brezat e ardhshëm të trashëgimisë kulturore dhe natyrore e referuar në Nenet 1 dhe 2 e që ndodhet në territorin e tij, i përket kryesisht atij shteti. Ai do të bëjë gjithçka që mundet në këtë përfundim, deri në fund të burimeve të tij dhe, atje ku është e përshtatshme, me ndonjë ndihmë dhe bashkëpunim ndërkombëtar, në veçanti, financiare, artistike, shkencore dhe teknike, të cilat mund të jetë në gjendje për ti përfituar.

Neni 5

Për të garantuar marrjen e masave efektive dhe aktive për mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore që ndodhet në territorin e tij, çdo Shtet Palë në këtë Konventë do të përpiqet, aq sa është e mundur, dhe e përshtatshme:

- a) të përshtatë një politikë të përgjithshme e cila ka si synim ti japë trashëgimisë kulturore dhe natyrore një funksion në jetën e komunitetit dhe të integrojë mbrojtjen e kësaj trashëgimie në programe të përgjithshme planifikuese;
- b) të ngrejë brenda territorit të tij, atje ku këto shërbime nuk ekzistojnë, një ose më shumë shërbime për mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore me një staf të përshtatshëm dhe që ka mundësitë për të kryer funksionet e veta;
- c) të zhvillojë studime shkencore dhe teknike, kërkime, dhe të përgatisë metoda operative të atilla që do ta bënin shtetin të aftë për tu kundërvënë rreziqeve që kërcënojnë trashëgiminë e tij kulturore ose natyrore;
- d) të marrë masat e duhura ligjore, shkencore, teknike, administrative dhe financiare të nevojshme për identifikimin, mbrojtjen, konservimin, prezantimin dhe rehabilitimin e kësaj trashëgimie; dhe

e) të nxisë themelimin ose zhvillimin e qendrave kombëtare dhe rajonale për trajnim në mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe të inkurajojë kërkime shkencore në këtë fushë.

Neni 6

1. Ndërsa respektojnë plotësisht sovranitetin e shteteve në territorin e të cilave ndodhet trashëgimia kulturore dhe natyrore e përmendur në Nenet 1 dhe 2, dhe pa paragjykim ndaj së drejtës së pronësisë e garantuar dhe nga legjislacioni kombëtar, Shtetet Palë në këtë Konventë pranojnë se kjo trashëgimi përbën një trashëgimi botërore për mbrojtjen e së cilës është detyrë e komunitetit ndërkombëtar si një i tërë që të bashkëpunojë.

2. Shtetet Palë angazhohen në përputhje me dispozitat e kësaj konvente, të japin ndihmën e tyre në identifikimin, mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore siç referohet në paragrafët 2 dhe 4 të Nenit 11 në rast se këtë e kërkojnë Shtetet në territorin e të cilave ajo ndodhet.

3. Çdo Shtet Palë në këtë Konventë angazhohet që të mos marrë asnjë masë të paramenduar e cila mund të dëmtojë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë trashëgiminë kulturore dhe natyrore referuar në Nenet 1 dhe 2 e që ndodhet në territorin e Shteteve të tjera Palë në këtë Konventë.

Neni 7

Për qëllimet e kësaj Konvente, mbrojtja ndërkombëtare e trashëgimisë kulturore dhe natyrore do të nënkuptojë themelimin e një sistemi bashkëpunimi dhe ndihme ndërkombëtare e projektuar që të mbështesë Shtetet Palë në Konventë në përpjekjet e tyre për të konservuar dhe identifikuar këtë trashëgimi.

III KOMITETI NDËRQEVERITAR PËR MBROJTJEN E TRASHËGIMISË BOTËRORE KULTURORE DHE NATYRORE

Neni 8

1. Një Komitet Ndërqeveritar për mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore Kulturore dhe Natyrore me Vlerë të Jashtëzakonshme Universale, i quajtur "Komiteti i Trashëgimisë Botërore" themelohet në këtë mënyrë brenda Organizatës të Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO). Komiteti do të përbëhet nga 15 Shtete Palë në Konventë, të zgjedhura nga vetë Shtetet Palë në Konventë të cilat do të mblidhen në asamblenë e përgjithshme gjatë seancës së zakonshme të Konferencës së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën. Numri i shteteve anëtare në Komitet do të rritet në 21 duke filluar që nga data e seancës së zakonshme të Konferencës së Përgjithshme menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj konvente nga të paktën 40 shtete.

2. Zgjedhja e anëtarëve të Komitetit do të garantojë një përfaqësim të barabartë të rajoneve dhe kulturave të ndryshme të botës.

3. Një përfaqësues i Qendrës Ndërkombëtare për Studimin e Ruajtjes dhe Restaurimit të Pasurisë Kulturore (ICCROM), një përfaqësues i Këshillit Ndërkombëtar të Monumenteve dhe Siteve (ICOMOS) dhe një përfaqësues i Bashkimit Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës dhe Burimeve Natyrore (IUCN), të cilëve mund t'ju shtohen, me kërkesë të Shteteve Palë në Konventë që mblidhen në asamblenë e përgjithshme gjatë sesioneve të zakonshme të Konferencës së Përgjithshme të UNESCOs, përfaqësues të organizatave të tjera ndërqeveritare ose joqeveritare, me objektiva të ngjashme, mund të ndjekin mbledhjet e Komitetit në një kapacitet këshillues.

Neni 9

1. Koha në detyrë e Shteteve anëtare të Komitetit të Trashëgimisë Botërore do të shtrihet nga fundi i seancës së zakonshme të Konferencës së Përgjithshme gjatë së cilës ata zgjidhen deri në fund të seancës të tretë të zakonshme.

2. Koha në detyrë e një të tretës së anëtarëve të emëruar në kohën e zgjedhjeve të para gjithsesi do të përfundojë në fund të

seancës së parë të zakonshme të Konferencës së Përgjithshme pas asaj kur ata u zgjedhën; dhe koha e detyrës së një të trete tjetër anëtarësh të emëruar në të njëjtën kohë do të përfundojë në fund të sesionit të dytë të zakonshëm të Konferencës së Përgjithshme pas asaj gjatë së cilës ata u zgjedhën. Emrat e këtyre anëtarëve do të zgjidhen me short pas zgjedhjes së parë nga Presidenti i Konferencës së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën.

3. Shtetet anëtare të Komitetit do të zgjedhin si përfaqësues të tyre persona të kualifikuar në fushën e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore.

Neni 10

1. Komiteti i Trashëgimisë Botërore do të miratojë Rregullat e Procedurës.
2. Komiteti mundet që në çdo kohë të ftojë organizata publike ose private të marrin pjesë në takimet e tij për konsultim mbi probleme të veçanta.
3. Komiteti mund të krijojë organe konsultuese siç e gjykon të nevojshme për performancën e funksioneve të tij.

Neni 11

1. Çdo Shtet Palë në këtë Konventë, për aq sa do të jetë e mundur, do të paraqesë Komitetit të Trashëgimisë Botërore një inventar të pasurisë që është pjesë e trashëgimisë kulturore dhe natyrore e cila ndodhet në territorin e tij dhe e përshtatshme për tu përfshirë në listën e dhënë në paragrafin 2 të këtij Neni. Ky inventar, i cili nuk do të konsiderohet i shtuar, do të përfshijë dokumentacionin rreth vendndodhjes së pasurisë në fjalë dhe rëndësisë së saj.

2. Mbi bazën e inventarëve të paraqitura nga Shtetet në përputhje me paragrafin 1, Komiteti do të themelojë, përditësojë dhe publikojë, nën titullin e "Listës së Trashëgimisë Botërore", një listë të pasurive që janë pjesë e Trashëgimisë Kulturore dhe trashëgimisë natyrore, siç përcaktohet në Nenet 1 dhe 2 të kësaj Konvente, të cilat i konsideron se kanë vlerë të jashtëzakonshme universale, në përputhje me kriteret mbi të cilat është themeluar. Një listë e përditësuar do të shpërndalet të paktën çdo dy vjet.

3. Përfshirja e pasurisë në Listën e Trashëgimisë Botërore kërkon miratimin e shtetit të interesuar. Përfshirja e një pasurie që ndodhet në një territor, sovranitet ose juridiksion e cila pretendohet nga më shumë se një shtet nuk do të paragjykojë në asnjë mënyrë të drejtat e palëve për diskutim.

4. Komiteti do të themelojë, përditësojë, dhe publikojë kurdoherë që do ta kërkojnë rrethanat nën titullin "Lista e Trashëgimisë Botërore në Rrezik" një listë të pasurisë që shfaqet në Listën e Trashëgimisë Botërore për konservimin e së cilës nevojiten operacione dhe për të cilën është kërkuar asistencë nën këtë Konventë. Lista do të përmbajë një kosto të përafërt të këtyre operacioneve. Lista mund të përfshijë vetëm atë pasuri që bën pjesë në trashëgiminë kulturore dhe natyrore e cila kërcënohet nga rreziqe serioze dhe specifike, si: kërcënimi i zhdukjes i shkatërrimi i përshtetshëm, projekte të mëdha publike ose private, ose projekte të shpejta urbane ose të zhvillimit të turizmit; shkatërrimi i shkatërruar nga ndryshimet në përdorimin ose pronësinë e tokës; ndryshime të mëdha si rrjedhojë e shkaqeve të panjohura; braktisja për çfarëdo arsye; shpërthimi ose kërcënimi i një konflikti të armatosur; fatkeqësi dhe kataklizma, zjarreve serioze, tërmeteve, rrëshqitjes së tokës; shpërthimeve vullkanike, ndryshimeve në nivelin e ujit, përmbytjeve dhe dallgëve të mëdha. Komiteti mundet që në çdo kohë, në rast të një nevojë urgjente, të bëjë një hyrje të re në Listën e Trashëgimisë Botërore në Rrezik dhe ta publikojë këtë hyrje menjëherë.

5. Komiteti do të përcaktojë kriteret mbi bazat e të cilave një pasuri që i përket trashëgimisë natyrore dhe kulturore mund të përfshihet në njërin prej listave që përmenden në paragrafët 2 dhe 4 të këtij neni.

6. Përpara se të refuzojë një kërkesë për tu përfshirë në njërin nga dy listat e përmendura në paragrafët 2 dhe 4 të këtij neni, Komiteti do të konsultojë Shtetin Palë në territorin e të cilit ndodhet pasuria kulturore dhe natyrore në fjalë.

7. Komiteti, me miratimin e Shteteve të interesuara, do të koordinojë dhe inkurajojë studime dhe kërkime që duhen për të hartuar listat e referuara në paragrafët 2 dhe 4 të këtij Neni.

Neni 12

Fakti se një pasuri që i përket trashëgimisë kulturore dhe natyrore nuk është përfshirë në asnjë prej të dy listave të përmendura në paragrafin 2 dhe 4 të Nenit 11 nuk do të interpretohet në asnjë mënyrë se nuk ka asnjë vlerë të jashtëzakonshme universale për qëllime të tjera ndaj atyre që rezultojnë nga përfshirja në këto lista.

Neni 13

1. Komiteti i Trashëgimisë Botërore do të marrë dhe studiojë kërkesat për ndihmë ndërkombëtare të formuluar nga Shtetet Palë në këtë Konventë në lidhje me pasurinë që është pjesë e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, e ndodhur në territoret e tyre, e të përfshira ose potencialisht të përshtatshme për tu përfshirë në listat e përmendura dhe të vërtetuara në paragrafët 2 dhe 4 të Nenit 11. Qëllimi i këtyre kërkesave mund të jetë që të garantojnë mbrojtjen, konservimin, prezantimin ose rehabilitimin e kësaj pasurie.

2. Kërkesat për ndihmë ndërkombëtare nën paragrafin 1 të këtij neni mund gjithashtu të lidhen me identifikimin e pasurisë kulturore dhe natyrore e përcaktuar në nenet 1 dhe 2, kur investigime paraprake kanë treguar se hulumtime të mëtejshme do të jenë të justifikuara.

3. Komiteti do të vendosi mbi veprimin që duhet marrë në lidhje me këto kërkesa, të vendosi, atje ku është e përshtatshme, natyrën dhe madhësinë e kësaj ndihme, e të autorizojë marrjen, e masave të nevojshme me qeverinë e interesuar.

4. Komiteti do të vendosi një radhë prioritetesh për operacionet e tij. Duke bërë këtë gjë do të ketë gjithmonë parasysh rëndësinë respektive për trashëgiminë kulturore dhe natyrore botërore të pasurisë që kërkon mbrojtje, nevojën për ti dhënë ndihmë ndërkombëtare pasurisë që është më shumë përfaqësuese e një mjedisi natyror se të gjenisë dhe të historisë së popujve të botës, emergjencën e punës që duhet bërë, burimet në dispozicion të shteteve në territorin e të cilave ndodhet

pasuria e kërcënuar dhe në veçanti shkallën e aftësisë së tyre për ta ruajtur këtë pasuri me mjetet dhe mundësitë e tyre.

5. Komiteti do të hartojë, përditësojë dhe publikojë një listë të pasurive për të cilat është dhënë ndihmë ndërkombëtare.

6. Komiteti do të vendosi mbi përdorimin e burimeve të Fondit të themeluar sipas Nenit 15 të kësaj Konvente. Do të kërkojë rrugë për të shtuar këto burime dhe do të marrë të gjitha masat e dobishme në këtë përfundim.

7. Komiteti do të bashkëpunojë me organizata ndërkombëtare e kombëtare qeveritare e joqeveritare që kanë objektiva të ngjashme me ato në konventë. Për zbatimin e projekteve dhe programeve të tij, Komiteti mund të kërkojë ndihmën e organizatave, veçanërisht Qendrës Ndërkombëtare për Studimin e Ruajtjes dhe Restaurimit të Pasurisë Kulturore (ICROM), Këshillit Ndërkombëtar të Monumenteve dhe Siteve (ICOMOS) dhe Bashkimit Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës dhe Burimeve Natyrore (IUCN), si dhe organeve publike e private e individëve të veçantë.

8. Vendimet e Komitetit do të merren nga një shumicë prej dy të tretat e anëtarëve të tij që janë prezent dhe votojnë

Neni 14

1. Vendimet e Komitetit do të asistohen nga Sekretariati i zgjedhur nga Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO).

2. Drejtori i Përgjithshëm (i UNESCO) duke vënë në përdorim sa më shumë të jetë e mundur shërbimet e Qendrës Ndërkombëtare për Studimin e Mbrojtjes dhe Restaurimit të Pasurisë Kulturore (ICRROM), Këshillit Ndërkombëtar të Monumenteve dhe Siteve (ICOMOS), dhe Bashkimit Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës dhe Burimeve Natyrore (IUCN) në zonat e tyre respektive të kompetencës, do të përgatisë dokumentacionin e Komitetit dhe axhendën e takimeve të tij dhe do të ketë përgjegjësinë për zbatimin e vendimeve të tij.

IV. FONDI PËR MBROJTJEN E TRASHËGIMISË BOTËRORE KULTURORE DHE NATYRORE

Neni 15

1. Themelohet në këtë mënyrë një fond për Mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore Kulturore dhe Natyrore me Vlerë të Jashtëzakonshme Universale, i quajtur "Fond i Trashëgimisë Botërore".

2. Fondi do të jetë një Fond në Mirëbesim, në përputhje me dispozitat e Rregullave Financiare të UNESCOs.

3. Burimet e Fondit do të përbëhen nga:

a) kontribute të detyrueshme dhe vullnetare të dhëna nga Shtetet Palë në këtë Konventë;

b) kontributet, dhuratat ose trashëgimitë e dhëna nga

(i) shtetet e tjera;

(ii) organizatat e tjera të sistemit të Kombeve të Bashkuara, veçanërisht Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara ose organizata të tjera ndërqeveritare;

(iii) organe publike dhe private ose individë;

c) nga ndonjë interes që vjen nga burimet e Fondit;

d) fondet e ngritura nga grumbullimet dhe faturat nga evenimentet e organizuara për të mirën e fondit; dhe

e) nga të gjitha burimet e autorizuara nga rregullat e Fondit, ashtu siç janë hartuar nga Komiteti i Trashëgimisë Botërore;

4) kontributet për Fondin dhe format e tjera të ndihmës të vëna në dispozicion të Komitetit mund të përdoren vetëm për ato qëllime që do të përcaktojë Komiteti. Komiteti mund të pranojë kontribute për tu përdorur vetëm për një program ose projekt të caktuar, me kusht që Komiteti do të ketë vendosur për zbatimin e këtij programi ose projekti. Asnjë kusht politik nuk mund t'i bashkëngjitet kontributeve që bëhen në Fond.

Neni 16

1. Pa paragjykuar asnjë kontribut vullnetar shtesë, Shtetet Palë në këtë Konventë angazhohen ti paguajnë rregullisht, ç'do dy vjet, Fondit të Trashëgimisë Botërore, shumën e të cilit, në formën e një përqindjeje të njëjtë të zbatueshme për të gjitha Shtetet, do të vendoset nga Asambleja e Përgjithshme e Shteteve Palë në Konventë, që do të mbledhet gjatë sesioneve të Konferencës së Përgjithshme të UNESCOs. Ky vendim i Asamblesë së Përgjithshme kërkon pjesën më të madhe të Shteteve Palë që janë prezent dhe votojnë, e që nuk e kanë bërë deklaratën e referuar në paragrafin 2 të këtij Neni. Në asnjë rast kontributi i detyrueshëm i Shteteve Palë në Konventë nuk do të kalojë 1% të kontributit të buxhetit të rregullt të UNESCOs.

2. Gjithsesi, çdo shtet i referuar në Nenet 31 ose 32 të kësaj Konvente mund të deklarojë në kohën e depozitimit të instrumentit të ratifikimit, të pranimit ose hyrjes, se nuk do të jetë i detyruar nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij Neni.

3. Një shtet Palë në Konventë i cili ka bërë deklaratën e referuar në paragrafin 2 të këtij Neni mund që në çdo kohë të tërheqë deklaratën në fjalë duke njoftuar Drejtorin e Përgjithshëm të UNESCOs. Gjithsesi, tërheqja e deklaratës nuk do të ketë efekt në lidhje me kontributin e detyrueshëm që i takon shtetit deri në datën e Asamblesë së Përgjithshme pasuese të Shteteve Palë në këtë Konventë.

4. Në mënyrë që Komiteti të mund të planifikojë operacionet e tij në mënyrë të efektshme, kontributet e Shteteve Palë në këtë Konventë të cilat e kanë deklaratën e referuar në Paragrafin 2 të këtij Neni, do të paguhet në mënyrë të rregullt, të paktën çdo dy vjet, dhe nuk duhet të jetë më pak se kontributet të cilat ata duhet të kenë paguar nëse ata do të ishin të detyruar nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij Neni.

5. Çdo Shtet Palë në Konventë i cili është i prapambetur me pagesën e kontributit të tij të detyrueshëm ose vullnetar për vitin aktual dhe vitin kalendarik që e paraprin atë, nuk do të jetë i përzgjedhshëm si Anëtar i Komitetit të Trashëgimisë Botërore, megjithëse kjo dispozitë nuk do të zbatohet për zgjedhjen e parë.

Koha në detyrë e secilit Shtet i cili është anëtar i Komitetit do të përfundojë në kohën e zgjedhjeve që jepen në Nenin 8, Paragrafin 1 të kësaj Konvente.

Neni 17

Shtetet Palë në këtë Konventë do të marrin në konsideratë ose inkurajojë themelimin e fondacioneve kombëtare publike dhe private ose organizatave qëllimi i të cilave është ë ftojë donacione për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore siç përcaktohet në Nenet 1 dhe 2 të kësaj Konvente.

Neni 18

Shtetet Palë në këtë Konventë do të japin asistencën e tyre ndaj fushatave ndërkombëtare për ngritjen e fondeve të organizuara për Fondin e Trashëgimisë Kulturore sipas principeve të UNESCO. Ato do të lehtësojnë grumbullimet e bëra nga organet e bëra në paragrafin 3 të Nenit 15 për këtë qëllim.

V. KUSHTET DHE DISPOZITAT PËR NDIHMË NDËRKOMBËTARE

Neni 19

Çdo Shtet Palë në këtë Konventë mund të kërkojë asistencë ndërkombëtare për pasurinë që është pjesë e trashëgimisë kulturore dhe natyrore me vlerë të jashtëzakonshme universale brenda territorit të tij. Shteti në fjalë paraqet me kërkesën e tij informacionin dhe dokumentacionin siç kërkohet në Nenin 21, ashtu siç e zotëron dhe që do të mundësojë Komitetit të arrijë një vendim.

Neni 20

Subjekt i dispozitave të paragrafit 2 të Nenit 13, nën paragrafëve (c) të Nenit 22 dhe Nenit 23, asistencë ndërkombëtare që jepet nga kjo Konventë mund të jepet vetëm pasurisë që është pjesë e trashëgimisë kulturore dhe natyrore për të cilën Komiteti i Trashëgimisë Kulturore ka vendosur, ose mund të vendosë, për ta përfshirë në një nga listat e përmendura në paragrafët 2 dhe 4 të Nenit 11.

Neni 21

1. Komiteti i Trashëgimisë Botërore do të përcaktojë procedurën me anën e së cilës kërkesat ndaj tij për asistencë ndërkombëtare do të konsiderohen dhe do të specifikojnë përmbajtjen e kërkesës, e cila duhet të përcaktojë operacionin që synohet të kryhet, punën që është e nevojshme, koston si rrjedhojë e operacionit, shkallën e nevojës dhe arsyet përse burimet e Shtetit që kërkon asistencë nuk e lejojnë atë të përballë të gjitha shpenzimet. Këto kërkesa duhet të mbështeten nga raporte ekspertësh kurdoherë që është e mundur.

2. Kërkesave që bazohen mbi shkatërrime ose fatkeqësi natyrore duhet për arsye të punës urgjente të cilën ato kanë, tu jepet një vlerësim prioritar dhe i menjëhershëm nga Komiteti, i cili duhet të ketë një fond rezervë në dispozicion të tij për këto kontingjente.

3. Përpara se të marrë një vendim, Komiteti duhet të ndër marrë konsultime dhe studime të atilla siç e parashikon ligji.

Neni 22

Asistencë e dhënë nga Fondi i Trashëgimisë Botërore mund të marrë format e mëposhtme:

(a) studime në lidhje me problemet artistike, shkencore dhe teknike që ngrihen nga mbrojtja, konservimi, prezantimi dhe rehabilitimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore, siç përcaktohet në paragrafët 2 dhe 4 të Nenit 11 të kësaj Konvente;

(b) pajisjen me ekspertë, teknikë dhe punë të kualifikuar për të garantuar që puna e aprovuar të ndërmerret;

(c) trajnimin e stafit dhe specialistëve në të gjithë nivelet në fushën e identifikimit, mbrojtjes, konservimit, prezantimit dhe rehabilitimit të trashëgimisë kulturore dhe natyrore;

(d) furnizimin me pajisje të cilat Shteti i interesuar nuk i zotëron ose nuk është në një pozicion që të mund të marrë;

(e) borxhe me interes të ulët ose pa interes të cilat mund të ri-paguhet me afat të gjatë;

(f) financimin, në raste të jashtëzakonshme dhe për arsye të veçanta, të subvencionimeve që nuk mund të ri-paguhet.

Neni 23

Komiteti i Trashëgimisë Botërore mund gjithashtu të japë asistencë ndërkombëtare qendrave kombëtare dhe rajonale për

trajnimin e stafit dhe specialistëve në të gjitha nivelet në fushën e identifikimit, mbrojtjes, konservimit, prezantimit dhe rehabilitimit të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Neni 24

Asistenca ndërkombëtare në shkallë të madhe do të paraprihet nga studime të detajuara shkencore, ekonomike dhe teknike. Këto studime do të mbështeten mbi teknikat e avancuara për mbrojtjen, konservimin, prezantimin dhe rehabilitimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore e do të jenë konsistente me objektivat e kësaj Konvente. Studimet do të kërkojnë gjithashtu metoda për të përdorur në mënyrë racionale burimet në dispozicion të Shtetit të interesuar.

Neni 25

Si rregull i përgjithshëm vetëm një pjesë e kostos së punës së nevojshme do të përballohet nga komuniteti ndërkombëtar. Kontributi i Shtetit që përfiton nga asistenca ndërkombëtare do të përbëjë një pjesë substanciale të burimeve që i kushtohen secilit program ose projekt, e kundërta ndodh vetëm nëse burimet e tij nuk e lejojnë këtë gjë.

Neni 26

Komiteti i Trashëgimisë Botërore dhe Shteti marrës do të përcaktojnë në marrëveshjen që do të përfundojnë midis tyre kushtet sipas të cilave do të zbatohet një program ose projekt për të cilin jepet asistencë ndërkombëtare sipas kushteve të kësaj Konvente. Do të jetë përgjegjësia e Shtetit që merr këtë asistencë ndërkombëtare për të vazhduar që të mbrojë, konservojë dhe prezantojë pasurinë e ruajtur në këtë mënyrë, duke respektuar kushtet e parashtruara nga marrëveshja.

VI. PROGRAMET EDUKATIVE

Neni 27

1. Shtetet Palë në këtë Konventë do të përpigën me të gjitha mënyrat e përshtatshme, dhe në veçanti nëpërmjet programeve edukative dhe informative, të fuqizojnë vlerësimin dhe respektin nga ana e njerëzve të tyre për trashëgiminë kulturore dhe natyrore të përcaktuar në Nenet 1 dhe 2 të Konventës.

2. Ata angazhohen ta mbajnë publikun gjerësisht të informuar mbi rreziqet që kërcënojnë këtë trashëgimi dhe të aktiviteteve që ndërmerren në ndjekje të kësaj Konvente.

Neni 28

Shtetet Palë në këtë Konventë të cilët marrin asistencë ndërkombëtare sipas Konventës do të marrin masat e përshtatshme për ta bërë të njohur rëndësinë e pasurisë për të cilën është marrë asistencë dhe roli që luan kjo asistencë.

VII. RAPORTET

1. Shtetet Palë në këtë Konventë do të japin, në raportet të cilat ato ja dorëzojnë Konferencës së Përgjithshme të UNESCOs, ku datat dhe mënyra vendosen nga kjo e fundit, informacion mbi dispozitat ligjore dhe administrative të cilat ata kanë miratuar dhe veprime të tjera të cilat ata kanë marrë për aplikimin e kësaj Konvente, së bashku me detajet e eksperiencës të fituar në këtë fushë.

2. Këto raporte do të sillen në vëmendjen e Komitetit të Trashëgimisë Botërore.

3. Komiteti do të dorëzojë një raport për aktivitetet e tij në secilën prej seancave të zakonshme të Konferencës së Përgjithshme të UNESCOs

VIII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 30

Kjo Konvente është hartuar në Arabisht, Anglisht, Frëngjisht, Rusisht dhe Spanjisht, dhe të pestë tekstet kanë autoritet të njëjtë.

Neni 31

1. Kjo Konventë do të jetë subjekt i ratifikimit së pranimit nga Shtetet anëtare të UNESCOs në përputhje me procedurat e tyre kushtetuese përkatëse.

Neni 32

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për tu pranuar nga të gjitha Shtetet që nuk janë anëtare të UNESCOs të cilat ftohen nga Konferenca e Përgjithshme e Organizatës që ta miratojnë atë.

2. Miratimi do të marrë efekt me depozitimin e një instrumenti pranimi tek Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës.

Neni 33

Kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të 20-të të ratifikimit, pranimit ose miratimit, por vetëm në lidhje me ato Shtete të cilat kanë depozituar instrumentet e tyre përkatëse të ratifikimit, pranimit ose miratimit në atë ose para asaj date. Do të hyjë në fuqi për ç'do shtet tjetër tre muaj pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Neni 34

Dispozitat e mëposhtme do të aplikohen për ato Shtete Palë në këtë Konventë të cilat kanë një sistem kushtetues federal ose jo unik:

(a) në lidhje me dispozitat e kësaj Konvente, zbatimi i të cilave ndodhet nën juridiksionin ligjor të pushtetit ligjvënës federal ose qendror, detyrimet e qeverisë federale ose qendrore do të jenë të njëjta si për ato Shtete palë të cilat nuk janë Shtete Federale.

(b) në lidhje me dispozitat e kësaj Konvente, zbatimi i të cilave ndodhet nën juridiksionin ligjor të Shteteve përbërëse individuale, vendeve, provincave ose kantoneve që nuk janë të detyruara nga sistemi kushtetues i federatës për të marrë masa ligjore, qeveria federale do të informojë autoritetet kompetente të këtyre Shteteve, vendeve, provincave ose kantoneve për dispozitat në fjalë, shoqëruar me rekomandimin e saj për miratimin e tyre.

Neni 35

1. Çdo Shtet Palë në këtë Konventë mund ta denoncojë këtë Konventë.
2. Denoncimi do të njoftohet me anën e një instrumenti me shkrim që do të depozitohet pranë Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCOs.
3. Denoncimi do të ketë efekt dymbëdhjetë muaj pas marrjes së instrumentit të denoncimit. Nuk do të ndikojë në detyrimet financiare të Shtetit akuzues deri në datën kur tërheqja hyn në fuqi.

Neni 36

Drejtori i Përgjithshëm i UNESCOs do të informojë Shtetet anëtare të Organizatës, Shtetet jo anëtare të Organizatës të cilat referohen në Nenin 32 si dhe Kombet e Bashkuara, për depozitimin e të gjithë instrumenteve të ratifikimit, pranimi ose miratimit që parashikohet në Nenet 31 dhe 32, dhe për denoncimet që parashikohen në Nenin 35.

Neni 37

1. Kjo Konventë mund të rishikohet nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCOs. Gjithsesi çdo rishikim i tillë do të zbatohet vetëm për Shtetet të cilat do të bëhen palë në rishikimin e Konventës.
2. Nëse Konferenca e Përgjithshme do të miratojë një Konventë të re duke e rishikuar këtë Konventë të gjithën ose pjesërisht, përveçse kur Konventa e re është shtojcë, kjo Konventë nuk do të jetë më e hapur për ratifikim, pranim ose miratim, që nga data në të cilën Konventa e re e rishikuar do të hyjë në fuqi.

Neni 38

Në përputhje me Nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, kjo Konventë do të regjistrohet në Sekretariatin e Kombeve të Bashkuara me kërkesën e Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCOs.

Përfunduar në Paris, këtë ditë të 23-të Nëntorit 1972, në dy kopje origjinale që mbajnë firmat e Presidentit të sesionit të 17-të të Konferencës së Përgjithshme dhe të Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCOs, të cilat do të depozitohen në arkivat e UNESCOs, dhe kopje të certifikuara të së cilave do ti shpërndahen të gjithë Shteteve siç referohet në Nenet 31 dhe 32 si edhe Kombeve të Bashkuara.